



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj. Them. 830(31010-00096-83-2016)
Dt. Rregj. 29.01.2016

Nr. Vendimi 448 (366)
Dt. Vendimi 13.06.2016

V E N D I M
"NE EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana LITI, sot me datë 13.06.2016, ora 14.00 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. Rregj. Them. 830 (31010-00096-83-2016) datë 29.01.2016, që i përket palëve ndërgjyqëse::

PADITËSE:

Liljana Trokthi i bija e Palit e dtl. 24.11.1973, lindur e banues ne lagjen Nr.4 Laç, Bashkia Kurbin.Adresa: Lagjia Nr.4. Pall. 126, kati i pare, perballe Lokal Europa:Nr. Kontakti celular: 0686267550.

TE PADITUR:

- 1.Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë(në mungesë). ✓
- 2.Drejtoria e Apelimt Tatimor Tirane(në mungesë).

me pjesmarrie te:

Avokatura e Shtetit Shkodër (në mungesë).

OBJEKTI:

Shfuqizimi i Aktit Administrativ:Njoftim Vleresimi Nr. 8715/10 Prot. dt. 21.10.2015, nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe
Shfuqizimin tërësisht te vendimit nr. 34039/1 prot. te dt. 28.12.2016 te Drejtorise se Apelimt Tatimor Tirane,"Për anulimin e gjobës në shumën 100.000lekë".

BAZA LIGJORE:

Ligji 49/2012,"Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative, dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative" neni 17/ pika 1 germa "a" e ne vijim neni 40 i ketij ligji.Ligji 9220 i dt. 19\05\2008. I ndryshuar

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura, dhe pasi dëgjoi palen paditese, e cila kërkoi përfundimisht pranimin e kerkese padise sipas objektit të saj, në mungesë të palës së paditur që në praspime me shkrim

kërkojnë rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në ligj dhe prova, në mungesë të Avokaturës së Shtetit Shkodër, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

VËREN se:

Paditesia Subjekti fizik "Liljana Trokthi", rregjistruar ne organet tatimore me NIPT L17903301C, i eshte drejtuar gjykates administrative shkalle e pare Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane, me objekt:

Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vleresimin tatimor me nr.8715/10 prot date 21.10.2015 Drejtorise Rajonale Tatimore Lezhe si dhe shfuqizimin e Vendimit nr.34039/1 prot date 28.12.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane.

Gjykata referuar neneve 9, 7, 10, 11, 17, te Ligjit Nr. 49/2012 Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative, konstatoi juridiksionin gjyqesor dhe kompetencen lendore, funksionale dhe tokesore, te kesaj Gjykate per shqyrtimin e kerkese-padise.

Rrethanat e ceshtjes ;

Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe me date 29.05.2015, ne zbatim te urdherit te punes nr.436, te protokolluar me nr.5504 prot., date 22.09.2015, ka ushtruar kontroll ne subjektin Liljana Trokthi, ku eshte mbajtur akt-konstatimi me nr.0558580 date 25.09.2015.

Nga verifikimi i akt-konstatimeve te mbajtura ne subjektin e lartepemendur, rezultoi qe; "subjeki nuk ka deklaruar ne organin tatimor, 1 punonjes dhe ne momentin e kontrollit subjekti nuk leshon kupon tatimor".

Ne momentin e kontrollit ne pune u gjend Rrok Gjini, i identifikuar me karte identiteti me nr. ID G5111303IS dhe, subjekti ne momentin e kontrollit nuk leshon kupon tatimor.

Drejtoria Rajonale ka bere vleresimin e aktit te konstatimit ku subjekti rezultoi ne shkelje te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar si dhe udhezimit nr.24 date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, nenit 119 Mosdeklarimi i punonjesve dhe nenit 122 Kundravajtjet administrative ne perdorimin e pajisjeve fiskale, per leshimin e kuponave fiskale e te biletave, duke e gjobitur me 50.000 leke gjobe per nenin 199 dhe 50.000 leke per nenin 122 te ligjit 9920/2008.

Subjekti fizik Liljana Trokthi, eshte njoftuar per Njoftim Vlersimin Tatimore nr 8715/10 dt 21.10.2015, ndaj te cilit ka ushtruar ankim ne drejtorine e Apelimit Tatimore Tirane dhe kjo e fundit me vendimin nr. 34039/1 dt 28.12.2015 ka vendosur lenien ne fuqi te aktit administrative njoftim vleresim tatimore me nr 8715/10 dt 21.10. 2015 te DRT-lezhe.

Brenda afatit ligjore paditesia ka ushtruar te drejten e ankimit ne gjykatën administrative me kerkese padi, ku pretendon;

Jam tatimpaguese e rregullt dhe nuk kam patur ndonjehere shkelje te ligjit.

Sic pershkruhet ne akt konstatimin e dt 29.09.2011, ne momentin e kontrollit eshte gjetur ne pune Rrok Gjini, me nr Id 511130315, i cili eshte kunati im dhe nuk eshte i punesur tek une, pasi ai ka biznes te vetin.

Ndersa kasa fiskale ka qene me difekt dhe kam thirrur inxhinjerin per ta riparuar.

Per sa mesiper kerkoj pranimin e kerkese padise.

Ana e paditur (ne mungese) ne prapesimet e saj para gjykatës ka parashtuar se:

Pretendimet e subjekti nuk jane te mbeshtetura ne ligj. Administrata tatimore ka operuar ne perputhje me nenin 119 dhe 122 te ligjit 9920/2008, pasi ne momentin e kontrollit eshte gjetur ne pune nje punonjes i pa deklaruar me pare dhe kjo ne shkelje te nenit' 119, si dhe nuk leshonte kupon tatimore ne shkelje te nenit 122 te ligjit 9920/2008.

Pretendimet e paditeses ne kerkesë padi nuk kane asnje baze ligjore dhe provuesmerie .

Gjykata veren se;

Ne nenin 121, te ligjit 9920/2008 citohet se:

Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet ne rast se:

Nuk leshon kupon tatimor per te dokumentuar qarkullimin e realizuar te mallrave apo te sherbimeve:

*i) per cdo konstatim (verifikim) te kryer, me gjobe ne masen 200 000 (dyqind mije) leke per tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi fitimin, dhe gjobe, **ne masen 50 000 (pesedhjete mije) leke per tatimpaguesit e tjere.***

Ne nenin 119 citohet se :

Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor cdo te punesuar rishtazi, te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes, pervec detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve tatimore dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore, te llogaritura nga data e konstatimit, denohet me gjobe per cdo punonjes te padeklaruar si me poshte:

a) Tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobe prej 500 000 (peseqind mije) lekesh.

b) Tatimpaguesit e tjere, me gjobe prej 50 000 (pesedhjete mije) lekesh.

Ne udhezimin nr 24 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar Neni 55 paragrafi 1 percakton se :

Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te instalojne dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor.

Ne nenin 54 paragrafi 4 percakton se :

Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin qe shesin mallra apo sherbime me pakice por nuk jane te detyruar te pajisen me akte regjistruese ose pajisje te tjera fiskale si dhe personat e tatueshem tatimpagues i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel, qe shesin mallra e sherbime me pakice por qe gjithashtu nuk jane te detyruar te kene arke regjistruese ose pajisje te tjera fiskale, jane te detyruar te leshojne per cdo shitje qe kryejne detyra tatimore. Detyra tatimore eshte e detyruar te leshohet edhe ne cdo rast tjetër qe arkat regjistruese apo pajisjet e tjera fiskale, per cfaredo arsye qofte nuk janë në gjendje pune,

Udhezimi nr.23 date 09.12.2014 "Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore" ne pikën 6 e percakton se:

Organet tatimore kane te drejten dhe detyrimin te kontrollojne tatimpaguesit persona juridike dhe fizike per te verifikuar nese deklaratat dhe pagesat e kontributeve te detyrueshme jane te plota dhe te sakta, siç percaktohet ne ligjin nr. 9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar dhe ne udhezimin ne zbatim te tij.

Neni 119 i ligjit nr. 9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar e percakton se:

Organet tatimore duhet te kontrollojne punedhenesin per te verifikuar nese deklarimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe te kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore e shendetesore jane te plota dhe te sakta. Te gjitha tatimpaguesit duhet te deklarojne ne organin tatimor perkates te punesuarit (perfshire dhe punonjesit e papaguar te familjes se personit fizik me te cilet ai punon e bashkejeton ligjerisht), qe fillojne pune per here te pare te subjekti apo te punesuar rishtazi prane tij me te dhenat e kerkuara per secilin prej tyre. Ky deklarim duhet te behet te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes se te punesuarve.

Ne mbeshtetje te nenit 119 te ligjit nr. 9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", punonjesit e administrates tatimore, te autorizuar me shkrim, kryejne verifikime e kontrole ne vendndodhjen e biznesit lidhur me deklarimin e numrit te punonjesve. Nese nga verifikimi dhe kontrolli ne vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar ne organin tatimor cdo te punesuar, qe fillon pune per here te pare te tatimpaguesi apo te punesuar rishtazi prane tij, te pakten nje dite kalendarike perpara fillimit te punes (perfshire dhe punonjesit e papaguar te familjes se te vetepunesuarit me te cilet ai punon e bashkejeton), pervec detyrimit per pagimin e shumes se detyrimeve tatimore dhe kontributeve te papaguara te sigurimeve shoqerore e shendetesore, tatimpaguesi perkates detyrohet te paguaje edhe nje gjobe prej 50 000 (pesedhete mije) lekesh.

Referuar faktit rezulton se kontrolli tatimore eshte bere mbi bazen e nje urdher pune nr 963 dt 22.09.2015, me program te percaktuar.

Nga akt konstatimi i mbajtur ne vend me dt 25.09.2015 eshte konstatuar; Z. Rrok Gjini ne punë. Pretendimi i subjektit tatimpagues se eshte kunati i tij dhe nuk e ka patur te punesuar nuk eshte provuar para gjykates, si dhe pretendimi se kasa fiskale ishte me difekt dhe per kete kishte thirrur inxhinjerin qe ta riparonte, nuk eshte e justifikuar ne aktet nenligjore, pasi paditesia qe eshte subjekt i ligjit tatimore, duhet qe te paiset me kase fiskale dhe detyrimi i tij ligjore eshte te njoftojë difektin dhe inxhinjerin ta marrin tek kompania koncensionare e kasave me te cilen shteti ka kontraten dhe, eshte pikerisht kjo kompani qe riparon difektet e kasave fiskale, ndersa detyrim i subjektit eshte se ne rast difekti, te njoftoje menjehere administraten tatimore sipas ushzeimeve te siper cituara, dhe te leshoje kupon tatimore me bllok, gje te cilen nuk e ka bere dhe as nuk e ka provuar para gjykates por vetem e ka pretenduar.

Ne keto kushte veprimet e anes se paditur jane ne perputhje te plote me ligjin.

Perfundimisht gjykata vendos rrezimin e kerkese padise dhe, meqenese vlera e aktit eshte me e vogel se 20 fishi i pagës minimale në shkallë vendi, ky vendim është i formës së prerë, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40, 41, 42 dhe 45 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenit 126,306 dhe 310 të K.pr. Civile

VENDOSI

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40, 41, 42 dhe 45 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenit 126,306 dhe 310 të K.pr. Civile.

VENDOSI

- Rrëzimin e kërkesë padisë.
- Ky vendim është i formë së prerë, përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet menjëherë.
- Shpenzimet gjyqesore sic janë bërë
- Kundër vendimit nuk lejohet ankim.

Shkoder me date 13.06.2016

SEKRETARE SEANCE

Borana LITI



GJYQTARE

Valbona DURRAJ

